



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:155748
Datë: 08.03.2024
Numri i dokumentit: 05509331

Ac.nr.194/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Adnan Konushevcu - kryetar i kolegjit, Halide Reka dhe Naime Ahmeti, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit R.S nga K, Rruga B.M, p.nr., të cilin e përfaqëson i autorizuari Selmon Sadiku, avokat nga Kamenica, kundër të paditurit M.K nga fshati R, Komuna K..., të cilën e përfaqëson i autorizuari Enver Ajvazi, avokat nga Komuna në Kamenicë, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 500.00 euro, duke vendosur në lidhje me ankesën e të autorizuarit të paditurit, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.159/18 i datës 23.11.2020, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 08.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e themeltë ankesa e të autorizuarit të paditurit M.K nga fshati R, Komuna K..., NDRYSHOHEN pikat -I-, -II- dhe -IV-, të aktgjykimit të Gjykatës në Gjilan, Dega - Kamenicë C.nr.159/18 i datës 23.11.2020, dhe tani gjykohet si vijon: REFUZOHET në tërësi e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit R.S nga K, Rruga B.M, p.nr., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri M.K, që paditësit R.S, në emër të kaparit t'i kthej shumën prej 100.00 euro, dhe në emër të kompensimit për shkak të metave të sendit, t'ia, paguajë shumën prej 200.00 euro, apo gjithsejtë 300.00 euro, me kamatë vjetore prej 8 %, nga data 28.09.2018, dita e paraqitjes së padisë në gjykatën e shkallës së parë, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 503.00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbarimit.

II. Mbetet e pa shqyrtuar pika -III-, e Aktgjykimit të ankimuar C.nr.159/18 i datës 23.11.2020.

III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.159/18 i datës 23.11.2020, ka vendosur si në vijim: *“I. PJESËRISHT APROVOHET si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit R.S nga K..., rr.B.M”, pa nr. dhe; II. DETYROHET i padituri M.K nga fshati R, Komuna e K..., që paditësit në emër të kthimit të kaparit t'ia paguaj shumën prej 100 euro dhe në emër të kompensimit të dëmit për shkak të metave të sendit t'ia paguaj shumën prej 200 euro. e në shumë të përgjithshme prej 300 eurove, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 28.09.2018, si datë e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. III. Pjesa tjetër e shumës së kërkuar në lartësi prej 200 euro, në emër të kompensimit të dëmit për shkak të metave të sendit, përtej shumës së gjykuar si në pikën II të këtij dispozitivi, REFUZOHET SI E PA BAZUAR. IV. DETYROHET i padituri, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 300 euro, në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë, ndërsa shuma tjetër e kërkuar prej 203 euro, refuzohet si e pa bazuar”*.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Apelit ta aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj ose të prishet aktgjykimi dhe lënda të kthehet në rivendosje dhe rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur përfaqësuesi i paditësit i cili ka theksuar se aktgjykimi është i drejt dhe i bazuar në ligj, me propozim për këtë gjykatë që të refuzohet ankesa dhe aktgjykimi i goditur të vërtetohet si dhe i padituri ti paguan edhe shpenzimet për përgjigjes në ankesë, në shumën prej 120.00 euro.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e përfaqësuesit të paditurës është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit së tij, me datë 28.09.2018, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, të precizuar si në seancën e shqyrtimit kryesor me datën 23.11.2020, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e dëmit, me arsye si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.159/18 i datës 23.11.2020, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se nga provat e administruara, dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore si dhe në gjendjen faktike të vërtetuar. Gjykata e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka detyruar të paditurin, që paditësit në emër të kthimit të kaparit t'ia kthej, shumën prej 100 euro, ngase i padituri M.K kishte lidhur marrëveshje verbale me paditësin R.S, për rregullimin e kuzhinës shtëpiake dhe në emër të kësaj kishte marr i padituri shumën prej 100 euro si kapar. Mirëpo, gjykata ka vërtetuar se i padituri M.K , nuk e kishte rregulluar fare kuzhinën ashtu siç ishin marrëveshje me paditësin dhe as nuk i'a ka kthyer shumën prej 100 euro, që e kishte marr në emër të kaparit. Këtë fakt gjykata e vërtetoi, duke u bazuar në dëshminë e dëshmitarit Faik Sadiku, ngase i njëjti ka deklaruar se në momentin kur paditësi dhe i padituri kanë lidhur marrëveshje verbale për blerjen e kuzhinës shtëpiake ka qenë prezent dhe ka deklaruar se e din që paditësi, respektivisht vëllai i tij R.S, i'a ka dhënë shumën prej 100 euro si kapar M.K t për rregullimin e kuzhinës, poashtu këtij dëshmitari gjykata e vërtetoi edhe faktin se i padituri M.K , nuk e ka rregulluar fare kuzhinën dhe as që ja ka kthyer shumën prej 100 që e kishte marr si kapar, dëshmisë së këtij dëshmitari gjykata i'a fali besimin e plotë ngase i njëjti ishte i sinqertë, i kjoartë dhe i plotë në dëshminë e tij.

Mëtej gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se sa i përket të metave në sende, respektivisht dëmtimeve në orendit shtëpiake të blera nga paditësi R.S, gjykata erdhi në përfundim se më të vërtetë këto orendi kanë dëmtime të imëta, ngase këtë fakt gjykata e vërtetoi duke u bazuar në 5 fotot me ngjyra të cilat janë administruar si prova materiale në shqyrtimin kryesor e të cilat gjinden në shkresat e lëndës, e nga të cilat foto shihen me sy të lirë disa dëmtime të imëta të cilat i kanë këto orendi, poashtu faktin se këto orendi shtëpiake kanë qenë me dëmtime të imëta, në momentin kur shitësi i'a ka dërguar në shtëpi blerësit - paditësit, gjykata e vërtetoi edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve A.K dhe P.K, të cilët janë punëtor të të paditurit M.K t, e që dëshmitari Altin Kryeziu, ka deklaruar se ditën kur i kanë dërguar këto orendi shtëpiake në shtëpinë e R.S, vëllau i tij është ankuar për disa dëmtime, por ne si kompani i kemi premtuar se do t'i rregullojmë këto dëmtime brenda javës, poashtu edhe dëshmitari P.K, në dëshminë e tij ka deklaruar se ditën kur i kanë dërguar këto orendi në shtëpinë e R.S i kanë dëmtuar paksa, por ka shtuar se i kanë premtuar blerësit se do t'i rregullojnë shpejtë këto dëmtime, gjykata këtyre dëshmimeve të këtyre

dy dëshmitarëve u'a falë besimin e plotë, ngase këta janë personat që e din më së miri se a kanë pasur dëmtime apo jo këto orendit shtëpiake, ngase vet i kanë rregulluar dhe janë punëtor të të paditurit. Andaj duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar në bazë të provave të lartë cekura, e konform dispozitave ligjore të lartë cekura gjykata e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka detyruar të paditurin sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Ndërsa sa i përket pjesës tjetër të refuzuar të kërkesëpadisë si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, respektivisht shumën prej 200 euro, të kërkuar në emër të kompensimit për shkak të metave të sendit, gjykata ka ardhur në përfundim se kjo shumë e kërkuar përtej asaj të gjykuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duhet të refuzohet si e pa bazuar, ngase nga provat e administruara, konkretisht nga 5 fotot ku shihen orendit shtëpiake kontestuese, vërehet kjo se dëmet të cilat i përmbajnë këto orendi nuk janë në vlerën reale prej 400 eurove. Andaj edhe gjykata vendosi që shumën prej 200 euro, të kërkuar në emër të kompensimit për shkak të metave të sendit, përtej asaj të gjykuar ta refuzoj si të pa bazuar, jo reale dhe jo proporcionale me vlerën e dëmtimeve të cilat i kanë oriendit shtëpiake kontestuese.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452 par.3 të LPK-së dhe Tarifave të Odës së Avokatëve.

Vendimin mbi kamatën e ka marrë konform nenit 382 par.2 të LMD-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, mirëpo aktgjykimi i atakuar është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se Aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i Aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e Aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata ankimore, e vlerëson të qëndrueshëm pretendimin e të paditurit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që aktgjykimi i atakuar është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës

materiale. Gjykata e shkallës së parë në raport me palën ankuese ka vlerësuar se plotësohen të gjitha kushtet që e njëjta të jetë përgjegjëse për shkaktimin e dëmit lidhur me orendit lëndore, pasi ekzistojnë subjektet e marrëdhënieve të detyrimeve dhe të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar-shkaktuesi i dëmit dhe i dëmtuari, të ekzistojë fakti dëmtues nga rrjedh dëmi, të ekzistojë dëmi i shkaktuar, të ekzistojë kundërligjshmëria e veprimit, përkatësisht e mosveprimit nga është shkaktuar dëmi.

Gjykata me asnjë provë nuk ka vërtetuar aspektet qenësore që i referohen kompensimit të dëmit që mund të rrjedh nga mos përmbushja e detyrimeve ligjore. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka provuar se i padituri ka dështuar në kryerjen e detyrimeve ligjore dhe kushtetuese, në mënyrë që i njëjti të përgjigjet për shkaktimin e dëmit nga mosveprimi apo dëmtimi eventual i tyre, siç pretendon paditësi.

Pretendimet e paditësit, se i padituri është përgjegjës për dëmin e pretenduar që i është shkaktuar, një pretendim i tillë nuk është argumentuar, sepse nga shkresat e lëndës nuk rezulton se i padituri është përgjegjës, paditësi me asnjë provë të vetme materiale nuk ka arritur të argumentoj lëshimet e të paditurit, në mënyrë eventuale që të do të mund të kërkohej kompensimi. Në këtë rast përveç që nuk është argumentuar përgjegjësia e të paditurit, nga paditësi nuk është argumentuar as lartësia e dëmit që pretendon paditësi, por ka mjaftuar fakti që shkresave të lëndës, paditësi të ja bashkangjes disa foto më disa orendi-mobile, për shtëpi me disa shenja të dëmtimit, por sa i zhvlerësojnë këto dëmtime orendit-mobilet lëndore është tërësisht e pa argumentuar me prova shkresore. Sepse fillimisht paditësi në raport me të paditurin nuk ka të lidhur asnjë kontratë apo marrëveshje që nga e njëjta të mund të rrjedhin detyrimet reciproke, as nuk mund të vërtetohet për mes fotove se kush i ka bërë ato dëmtime që pretendohet, e as nuk mund të vlerësohet nga shikimi i fotove nga gjykata se sa është lartësia e dëmit të shkaktuar në këtë rast apo sa është zhvlerësimi i orendive lëndore si shkak i dëmtimeve, andaj në rastin konkret gjykata ankimore vlerëson se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e atakuar ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, kur vendosur që ta aprovon pjesërisht padinë e paditësit, sepse kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar ashtu siç u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ankimore po ashtu vlerësoi edhe kërkesën e paditësit që ka të bëjë me kthimin e kaparit, në shumën prej 100.00 euro, mirëpo e njëjta është e pabazuar sepse nuk plotësohen kushtet ligjore për kthimin e kaparit konform nenit 67 të Ligjit Ligj për Marrëdhëniet e Detyrimeve, për arsye se në këtë rast nuk kemi të lidhur ndonjë kontratë apo marrëveshje, që në formë të shenjës së është lidhur kontrata edhe është dhënë një shumë e mjeteve në formë kapari, mirëpo para se të vendoset lidhur me kthimin e kaparit ose jo, duhet të vërtetohet se i padituri në këtë rast çfarë

obligimesh ka pas për ti përmbushur, në raport me paditësin, a ka dështuar i padituri që ti përmbush këto detyrime dhe cilat kanë qenë obligimet e kontraktuara që ka dështuar paditësi, për tu plotësuar kushti i lartcekur ligjor për kthimin të kaparit. Në këtë rast nga shkresat e lëndës nuk rezulton me asnjë provë shkresore që i padituri ka pas ndonjë obligim në raport me paditësin siç edhe u vlerësua më lart, andaj edhe kërkesa e paditësit në raport me kthimin e kaparit është e pabazuar.

Për shkak të arsyeve të cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi, Gjykata e Apelit gjeti se aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë detyrimisht duhej të ndryshohej për faktin se aktgjykimi si i tillë nuk gjente mbështetje në dispozitat ligjore në fuqi dhe ishte i pa qëndrueshëm dhe i pa pranueshëm për këtë Gjykatë, andaj edhe vendosi si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës u mor konform nenit 450 lidhur me nenin 465.2, lidhur me nenin 463 të LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika e) në lidhje me nenin 201 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.194/21 me datë 08.03.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Adnan Konushevci d.v